



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Istogut
Opstina Istok
Municipality of Istog

Data: 13.06.2023

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Tel: 038/200 438 14

PROCESVERBALI

Mbledhja e Dëgjimit Publik e mbajtur me: 13.06.2022, e Marte, në ora 19:00, në Rakosh, si bashkësi lokale, me pjesëmarrës edhe të fshatrave (Uçë, Kernina, Syriganë, Cerkolez, Zhakovë, Padalishtë Shushicë e epërme dhe e ulët), për Kornizën Afatmesme Buxhetore të Komunës 2024-2026 (KABK).

Në mbledhje prezentë ishin Kryetari i Komunës, Ilir Ferati, Nënkryetari i Komunës, Ali Nimanaj, Drejtorë të drejtorive, zyrtar administrativ, si dhe qytetarë.

Kryetari i Komunës, Ilir Ferati - përshëndeti të gjithë të pranishmit, bëri prezantimin dhe sqarimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore të Komunës 2024-2026 (KABK) dhe inkurajoi qytetarët që të bëjnë propozimet e tyre, në mënyrë që këto propozime të bëhen pjesë e KAB-it.

Filloj në ora; 19:00

Nga qytetaret prezentë morëm këto:

- PROPOZIMET NGA DËGJIMI PUBLIK I MBAJTUR ME 13.06.2023 PËR KAB 2024- 2026

1.Kushtrim Sadikaj- Shushicë e Epërme:

-Ndërtimi i trotuareve shkolla- lagja Sadikaj- Hajdinaj(vazhdim) gjatësi rreth L=700m.

-Asfaltimi i disa rrugicave nëpër lagjet e fshatit.

-Trasimi i rrugës: Shushicë e Epërme- Shushicë e ulët(Lagja Salihaj) gjatësi rreth L=2000m,

-Ndërtimi i ndriçimit publik përgjatë rrugës kryesore, rrg. Isuf Sadikaj, konkretisht nga: Ambulanta- Shkolla-Lagja Sadikaj-Hajdinaj, gjatësi 1500m.

2.Armend Hajzeraj- Syriganë:

Shtimin e rrugës që lidh rrugën "Qafë mali" në rrugën "Januz Seferaj", pasi që na lidh më ambulanten e fshatit dhe shkollën.

3. Beqir Ibrahimaj- Zhakovë- Lagja Ibrahimaj

Rregullimi i vendit të varrezave
Rregullimi i shtëpisë për aktivitetet të fshatit
Ndriçimi i lagjes
Muret mbajtëse, premtim më i hershëm.

4. Ilir Jahaj- Rrg. Nak Berisha, Rakosh:

Të rregullohet një park dhe të bëhen disa parkingje, për stafin e kopshtit të fëmijëve në pjesën, saktësisht pjesa ku është i vendosur mulliri i vjetër, përgjatë rrugës "Nak Berisha".

5. Daut Arifaj- Uçë

Të shtrohet rruga në lagjen Arifaj në Uçë, në gjatësi prej 460m.

6. Imer Idrizaj- Zhakovë

Asfaltimi i rrugës Rakosh-Zhakovë nga lagja Jahaj deri te lagja Idrizaj dhe rrugët e tjera në Zhakovë të Ulët.

7. Besim Metaj- Shushicë e ulët:

Kanalizimi,
Shtëpia e fshatit
Rruga Loxha, Alushaj
Rregullimi i varrezave të fshatit.

8. Sadri Metaj- Kerrninë e poshtme

Ura në Kerrninë të poshtme
Rrugët Metaj dhe Danaj

9. Syl Salihaj- Rakosh

Të vendoset, Tabela Rakosh- Kerrninë

10. Shaban Sahitaj- Uçë

Ndriçimi publik dhe rrugicat në Uçë.

11. Granit Arifaj- Rakosh

Ndriçimi në rrugën Cen Muhaxheri-Rakosh

12. Zeqir Sadriaj- Cerkolez

Asfaltimi i rrugës "Kroni i Blinit" në gjatësi 1000m
Rregullimi i ujësjellësit.

13. Shefqet Haxhijaj- Rakosh

Riparimi i rrugës së bjeshkës Rakosh, Uçë, si dhe të hiqen mbeturinat në rrugën e Kerrninës së Epërme.

14. Bedri Haxhiu- Bellopoje

Furnizimi me ujë të pijshëm nga sistemi
Menaxhimi më i mirë i deponisë së mbeturinave.
Të rregullohet problemi me qenë endacak
Asfaltimi i disa rrugëve në tri lagje, me gjatësi totale, 400m
Hapja e një kanali për kullimin e tokave me gjatësi 1000m

15. Agim Fetahaj- Padalishtë

Furnizim me ujë të pijes
Ndriçimi i rrugës Bedri Fetahaj
Kanalizim

16. Imer Veselaj- Suhogerllë

Ndërtimi i murit mbrojtës.

Kryetari i Komunës, falënderoj të gjithë për pjesëmarrjen dhe kontributin e tyre
në këtë dëgjim publik të KAB-it.
Mbledhjen e shpallë të mbyllur:

Përfundoj në ora; 20:30

Procesmbajtës
Znj. Delvina Sylaj



Drejtori për Buxhet dhe Financa
z. Genc ADEMAJ

